



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa Abdi Toptani”, nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. Prot.

Tiranë, më / /2018

**V E N D I M**

**Nr. 203, Datë / / 2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR**

**NË AKADEMINË E SHKENCAVE, MBI “AUDITIMIN E PASQYRAVE  
FINANCIARE”.**

Nga auditimi i ushtruar në Akademinë e Shkencave, me objekt “*Auditimin e pasqyrave financiare*”, për periudhën 01.01.2017 deri në 31.08.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, duke vlerësuar pozitivisht punën e kryer nga Sekretari Shkencor dhe stafi, japim *opinion të pakualifikuar*<sup>3</sup>.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi auditimin e pasqyrave financiare*”, të ushtruar në Akademinë e Shkencave, Tiranë sipas programit të auditimit nr. 1199/1, dt. 08/10/2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 31.08.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

**A. OPINIONI I AUDITUESIT:**

***Baza për opinionin:***

KLSH ka audituar veprimtarinë e Akademisë së Shkencave, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”

dhe ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>2</sup>, si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Menaxhimi i ASH është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Përgjegjësia e auditimit është të shprehet në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se aktiviteti është kryer në përputhje me kuadrin rregullativ dhe se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

### ***I. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.***

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualet e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti ASH, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiar), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor deri me 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimeve, banka janë përfshirë në deklaratat financiare. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar për periudhën ushtrimore 2017-31.08.2018.

### ***Opinionin është i pakualifikuar<sup>3</sup>***

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Akademisë së Shkencave në datën 31 dhjetor 2017.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, por institucioni nuk ka hartuar Kodin e Etikës, si dhe; Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, nuk kanë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Plani strategji & Regjistri i Riskut janë hartuar nga institucioni por nuk janë miratua nga Titullari.

### **Rekomandojmë:**

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>3</sup> Një opinion i pakualifikuar jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

Institucioni të marrë masa në hartimin e Kodit të Etikës, me qëllim vendosjen e rregullave të sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, t'i ndihmoje ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vere ne dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike gjithashtu të marrë masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Akademia e Shkencave të marrë masa në miratimin e Strategjisë së Institucionit si dhe Regjistrin të riskut nga titullari i institucionit.

*Në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë hartuar dhe miratuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësi, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme.

**Rekomandojmë:**

Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Akademia e Shkencave të marrë masat për të hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

*Në vazhdimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në Akademinë e Shkencave nuk është hartuar dhe miratuar plani i trajnimeve e për pasojë nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikën më të mirë në fusha të ndryshme të cilat lidhen me veprimtarinë e punës së secilit Drejtori edhe pse në strategjinë e menaxhimit të riskut, referuar listës së risqeve të evidentuara si prioritare për institucionin është renditur ndër të parët trajnimi i stafit në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut.

**Rekomandojmë:**

Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë dhe miratojë planin e trajnimeve bazuar në kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

*Në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i kryer në formularin e inventarizimit të vlerave inventariale konstatohet se nga Akademia e Shkencave është dhënë në përdorim një pajisje “Gjeofizike-elektrometrike” me emërtimin “Reks-Rotag” për të cilën është hartuar një kontratë 1 vjeçare për periudhën Mars 2018 deri mars 2019. Në kontratën e lidhur me përdoruesin H..., është përcaktuar kryerja e studimeve eksperimentale të teknologjisë së Tomografisë së Rezistencës (ERT), pa përcaktuar detyrimet midis palëve siç mund të jenë përgjegjësia për dëmtime të mundshme dhe shpenzimet e riparimit. Gjithashtu nuk është përcaktuar tarifa e qirasë së përdorimit minimalisht sa norma e amortizimit vjetor të saj.

**Rekomandojmë:**

Për këtë, të merren masa për të ndryshuar kontratën e lidhur midis palëve, duke shtuar një nen të veçantë ku të përcaktohen të “drejtat dhe detyrimet e marrësit në dorëzim” për këtë pajisje.

*Në vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i gjendjes fizike të librit konstatohet se; në magazinë administrohet një numër i madh i titujve të librave të ndryshëm shkencorë vlera e të cilëve në fund të vitit 2017 është 50,637,850 lekë. Krahas vlerës së lartë të librave në magazinë, konstatohet se një sasi e konsiderueshme e titujve të disa librave janë stok për një kohë relativisht të gjatë, ndërkohë që do ishte me e drejtë shpërndarja e tyre në institucione apo shkolla për të justifikuar qëllimin e shpenzimeve për botimit të tyre në një tirazh që në disa tituj arrin deri 1,500 kopje.

### Rekomandojmë:

Nga kryesia e Akademisë së Shkencave të merren masa për shpërndarjen e tyre në institucione të ndryshme shtetërore ku edhe përshtatet përdorimi, apo edhe në shkolla publike që kanë interes në edukimin e nxënësve apo studentëve.

*Në vazhdimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e bilancit kontabël në fund të vitit 2017 konstatohet se llogaria 421 “Personeli dhe llogari të lidhura me to” në pasiv përfaqëson vlerën prej 1,624,749 lekë, ndërsa sipas analizave të llogarive dhe të derdhura në buxhet në muajin janar 2018 rezulton në vlerën prej 1,613,422 lekë (1,476,932 +35,547 +100,743), ose kjo llogari është më e madhe se detyrimet ndaj Tatim Taksave për shumën prej 11,327 lekë. Në muajin dhjetor është penalizuar institucioni nga dega e Tatim-Taksave për mos derdhje në afat të kontributit të sigurimeve shoqërore në shumën prej 5,081 lekë e cila ka kaluar në debi të llogarisë 421 dhe jo në shpenzime të përgjithshme të institucionit.

### Rekomandojmë:

Për këtë, në mbylljen e bilancit kontabël të vitit 2018 të merrën masa për të sistemuar llogarinë 421 “Personeli dhe llogari të lidhura me to” për shumën prej 11,327 lekë, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë 421 për shumën prej 11,327 lekë dhe në kredi të llogarisë të ardhura të ndryshme.(në pamundësi për t’u xhiruar në degën e tatim taksave)

*Në vazhdimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se Akademia e Shkencave, të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike i regjistron manualisht në ditar dhe në llogaritë e përkatëse. Këto libra apo ditarë nuk ruhen në formate elektronike nga institucioni, gjithashtu institucioni nuk përdor programet financiare për mbajtjen e kontabilitetit, duke mos gjeneruar në kohë reale të dhëna të cilat do të ndihmonin stafin menaxherial në vendimmarrje.

### Rekomandojmë:

Akademia e Shkencave të marrë të gjitha masat që në të ardhmen të sigurojë një proces automatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimit të shpalosjeve në pasqyrat financiare vjetore, duke përdorur programe financiare të mbajtjes së kontabilitetit, të cilat do të sigurojnë kontrolle të sigurta, efçente e efektive dhe i mundësojnë drejtuesit të institucionit marrjen e një garancie të besueshme që vendimet në lidhje me buxhetin, planifikimin etj, janë zbatuar siç duhet.

*Në vazhdimësi*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Vendimi dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit përcillen në formë rekomandimi në Akdeminë e Shkencave.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**